REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

SHESHI "NËNË TEREZA", REKTORATI I UT-së, TIRANË
TEL. +4 228402, FAX: +4 223981

VENDIM

Nr. 7, datë 30.01.2015

"Miratimi i qëndrimit të strukturave të Universitetit të Tiranës, për Projekt Ligjin e Arsimit të Lartë"

Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, i mbledhur më datë **30 Janar 2015**, pasi shqyrtoi qëndrimet e strukturave të UT, në nivel të departamenteve, të këshillave të fakulteteve dhe studentëve, për draftin e P/Ligjit të Arsimit të Lartë, rikonfirmoi një shkallë të lartë përgjegjësie të analizës dhe propozimeve të këtyre strukturave dhe në përfundim të diskutimeve:

KONSTATOI se:

1. **Drafti i P/Ligjit të AL bie ndesh me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë**

Neni 57/7 i Kushtetutës së RSH ku thuhet se: *"Autonomia e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe liria akademike janë të garantuara me ligj"*. Projekt Ligji i AL përbën regres flagrant në arritjet e siguruara nga stafet universitare ndër

vite, si dhe cënon sigurinë juridike të fituar të të gjitha grupeve të interesit. Qëllimi i aprovimit të një ligji të ri, duhet të jetë i mirë studiuar në përputhje me kushtet politike, ekonomike, sociale të një vendi.

2. **Drafti i P/Ligjit të AL shkel parimet themelore të Kartës së Bolonjës dhe Dekalaratës Evropiane të të Drejtave të Njeriut**

Arsimi i Lartë në Republikën e Shqipërisë është pjesë e Hapësirës Evropiane të Arsimit të lartë. Qeveria shqiptare ka nënshkruar të gjitha konventat dhe marrëveshjet që burojnë nga procesi i Bolonjës. Karta e Bolonjës ka tre shtylla themelore, mbi të cilat ngrihen dhe funksionojnë institucionet e arsimit të lartë: autonomia akademike, institucionale dhe financiare. Projektligji, në shumë prej neneve të tij, bie ndesh me kornizën e Kartës së Bolonjës.

3. **Drafti i P/Ligjit të AL ka një frymë të theksuar etatiste**

Fryma që përshkon P/Ligjin e AL, është etatiste duke krijuar një burokraci agjencish e strukturash "autonome" me drejtim të dretpërdrejtë nga Qeveria. Këto institucione (agjenci dhe struktura) janë të panjohura në asnjë praktikë tjetër euro-atlantike për Arsimin e Lartë. Ato ndërtojnë një sistem burokratik që i zë frymën aspektit të autonomisë dhe lirisë akademike. Shteti nga njëra anë kontrollon maksimalisht vendimarrjen dhe lirinë akademike, nga ana tjetër kufizon fondet publike për IAL publike duke rrezikuar ekzistencën e tyre.

4. **Studentët përjashtohen nga procesi i vendimarrjes**

Duke u nisur nga argumentat e mësipërme, Senati Akademik i UT vendosi:

1. Të miratojë vendimet e strukturave akademike të UT (këshillat e fakulteteve të Drejtësisë, Ekonomisë, Gjuhëve të Huaja, Shkencave Sociale, Shkencave të Natyrës, Historisë dhe Filologjisë, Instituti i Fizikës

Bërthamore dhe Këshillit Studentor UT), ku shprehet qartë mosaprovimi ndaj draftit të P/Ligjit të AL të propozuar dhe t'i përcjellë ato pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

2. Drafti përfundimtar të konsultohet edhe me partnerët ndërkombëtarë, Shoqata Evropiane të Ligjit, Arsimit dhe Politikës, sikurse e kemi shprehur edhe në Vendimin e mëparshëm të Senatit Akademik të UT, Nr. 53, datë 29.05.2014.

Si përfaqësuesi më i lartë akademik i Universitetit të Tiranës, Senati Akademik i UT kërkon që domosdosmërisht propozimet e hartuara me përgjegjësi maksimale nga strukturat e UT, të reflektohen në vijimësi.

Mbetemi në pritje të Draftit të ri të Ligjit për Arsimin e Lartë me përmirësimet përkatëse.

K R Y E T A R I

Prof. Dr. Dhori KULE